



European Union Special Representative in Kosovo

E Martë, 16 Shtator 2008

Përfaqësuesi Special i BE-së, Pieter Feith, informoi anëtarët e Parlamentit Evropian për gjendjen në Kosovë

Sot, Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë, z. Pieter Feith, informoi anëtarët e Komisionit të Punëve të Jashtme në Bruksel për zhvillimet më të fundit politike: *“Në përgjithësi, situata në Kosovë ka mbetur stabile dhe e qetë gjatë shtatë muajve të fundit”. Ai theksoj se “ne kemi marrëdhënie të mira pune me Qeverinë e Kosovës dhe me partnerët tanë ndërkombëtarë- që është shumë me rëndësi për ballafaqimin me sfidat që janë para nesh”.*

Ai mirëpriti në veçanti përparimin e bërë nga qeveria në fushën e legjislacionit, duke ofruar një kornizë të gjerë për mbrojtjen e komuniteteve pakicë, për trashëgiminë fetare dhe kulturore dhe për decentralizimin.

“Një hap tjetër i rëndësishëm i bërë përpara është se rikonfigurimi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) po vazhdon dhe po rrit dinamikën. Misioni i BE-së për sundimin e ligjit, EULEX, tash do të jetë në pozitë më të mirë për tu vendosur në tërë Kosovën për të mbështetur zhvillimin e një sistemi më të fuqishëm, të paanshëm dhe shumetnik të sundimit të ligjit”, ju tha Pieter Feith anëtarëve të Parlamentit Evropian.

Sa i përket marrëdhënieve me komunitetin serb, Pieter Feith theksoj se *“ne do të vazhdojmë përpjekjet tona me përfaqësuesit politik serb dhe me udhëheqësit e komunitetit për të ngritur vetëdijen se ne jemi në Kosovë për të ndihmuar në krijimin e një shoqërie në të cilën të gjithë do të ndjehen të sigurt dhe në të cilën respektohen dhe mbrohen të drejtat e të gjitha komuniteteve.”*

Përfaqësuesi Special i BE-së gjithashtu theksoi mundësitë që ka krijuar Konferenca e suksesshme e donatorëve në korrik të këtij viti. “Tash është me rëndësi jetike që ndihma e zotuar financiare të përdoret me mençuri dhe transparencë nga Qeveria e Kosovës. Jemi të sigurt se Qeveria do të vazhdojë të punojë për të bërë reformat e nevojshme dhe të përparoj në mënyrë të vazhdueshme drejt rrugës së saj për në BE”, tha Feith.

(ends)



Shënim për editorët:

Informatë mbi historikun e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (EUSR) në Kosovë:

Objektivi i Bashkimit Evropian në Kosovë është të përkrahë dhe ndihmojë autoritetet e Kosovës në zhvillimin e një Kosove stabile, të qëndrueshme, paqësore dhe shumetnike që bashkëpunon në mënyrë paqësore me fqinjët e saj në rajon. Për të promovuar këto objektiva, Këshilli i Bashkimit Evropian emëroi Pieter Feithin si Përfaqësues Special të BE-së (EUSR) në Kosovë më 4 shkurt 2008.

Mandati i tij është:

- të ofrojë këshillimin dhe përkrahjen e Bashkimit Evropian për Qeverinë e Kosovës në procesin politik drejt integritetit evropian
- të promovojë koordinimin e përgjithshëm të pranive të BE-së në Kosovë, si p.sh. Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian dhe Misionin e Sundimit të Ligjit EULEX (shih www.euinkosovo.eu)
- të sigurojë njëtrajshmëri dhe koherencë në veprimet e BE-së që kanë për synim publikun
- të ofrojë këshillim politik lokal për Drejtuesin e Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit, EULEX në Kosovë
- të kontribuojë në zhvillimin dhe konsolidimin e respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në Kosovë.

Z. Feith njëherësh mban edhe mandatin e veçantë si Përfaqësues Ndërkombëtar Civil (ICR) në Kosovë.

Për më shumë informata mbi EUSR-në në Konferencën e Donatorëve për Kosovën, luteni të thërrisni zëdhënësen e EUSR-së Julia Rueter + 377 509 760 ose të vizitoni www.eusrinkosovo.eu.